



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 411/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi, Kryesues, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga kandidati për deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës, Jollxhi Shala nga radhët e subjektit politik Kosovaki Nevi Romani Partia (KNRP) dega në Prizren, paraqitur kundër Vendimit të shpalljen e rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 29.06.2017, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 01.07.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Jollxhi Shala kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik Kosovaki Nevi Romani Partia (KNRP) me seli në Prizren .

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datën 30.06.2017 në ora 13:25, nga Jollxhi Shala kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik Kosovaki Nevi Romani Partia (KNRP) dega në Prizren, në të cilën ankesë ka pohuar se nga rezultatet finale të publikuara nga Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ), në komunën e Prizrenit brenda subjektit këtij politik, me rastin e numërimit të votave janë bërë gabime, pasi që ankuesi i ka 196 vota, ndërsa në realitet gjatë numërimit të votave janë konstatuar 234 vota, ne realitet me shumë vota se kandidatet tjerë te këtij subjekti politik për çka konsideron se i është cenuar e drejta ligjore.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **ankesa është e pabazuar**

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtruesi i ankesës me ankesën e tij kërkon që të vërtetohet saktësisht numërim i përgjithshëm i votave të tij në krahasim me kandidatët e tjerë brenda subjektit politik KNRP në

Komunën e Prizrenit, sepse nga rezultatet përfundimtare të publikuara nga KQZ-ja i posedon 196 vota, ndërsa gjatë numërimit të votave është konstatuar numri i përgjithshëm i votave 234 vota.

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar asnjë dëshmi për ti vërtetuar ato pretendime edhe pse barra e te provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, mirëpo i njëjti me asnjë provë apo dëshmi nuk ka argumentuar se në cilin vendvotim i janë bërë parregullsitë siç pretendon.

Parashtrimet në ankesë nuk paraqesin bazë ligjore për parregullsi dhe për rrjedhojë as referencë ligjore për marrjen e vendimit në favore për ankuesin.

Paneli vlerëso se pretendimet në ankesë nuk janë te bazuara dhe nuk i plotëson standardet ligjore si dhe kërkesat e nenit 117 të LZP-së.

PZAP-i, në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse lidhur me pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pa argumentuar me fakte dhe si e tillë e pabazuar .

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.411/2017 më datën 01.07.2017.

**Kryesuesi i Panelit  
Fejzullah Rexhepi**



#### ***Udhëzim Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*